REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.1624/9 Prot. Sarandë, më 04.03.2026

PROÇESVERBAL

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Sarandë që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:00
Data e mbajtjes së mbledhjes :27.02.2026
Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak
Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Sarandë: Kryetar i Bashkisë Z.Oltion Çaçi dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen.

Marrin pjesë :

1. Asaf Stroka
2. Gjergji Imeraj
3. Festim Mina
4. Zana Piro
5. Përparim Ahmeti
6. Bejdo Çela
7. Anjeza Dike
8. Dafina Allkushi
9. Elona Mano
10. Ermir Hoxha
11. Ibrahim Bajrami
12. Ilirjan Gërdhuqi
13. Enea Vasili
14. Pranvera Osmani
15. Lindita Kondi
16. Dritan Peçi
17. Laureta Çeçi
18. Shpëtim Ahmeti
19. Denisa Islamaj

20. Farie Hyska

Mungojnë :

21. Klejdjan Murtaj
22. Kevin Alikaj
23. Angjele Lapa
24. Ilva Qëndro
25. Eugen Qëndro
26. Indi Rrapaj
27. Xhino Jaçaj
28. Thanas Gurma
29. Vesel Koçiu
30. Katerina Beqo

Asaf Stroka : Përshëndetje !
Të nderuar Anëtarë të Këshillit Bashkiak! I nderuar Zv/Kryetar i Bashkisë!Të nderuar pjesëmarrës dhe përfaqësues të medias !
Zhvillojmë mbedhjen e Këshillit Bashkiak datë 27.02.2026, vijojmë bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, çdo fillim mbledhje miratohet rendi i ditës sipas thirrjes për zhvillimin e mbledhjes sipas rendit si më poshtë:

1. **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin Janar 2026".
2. **P/vendim** "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Janar 2026".
3. **P/vendim**"Mbi miratimin e projekt-propozimit për ofrimin e shërbimit"PAK përtej distancës".
4. **P/vendim**"Për miratimin e shtetases V.P për t'u trajtuar në qendrën polivalente ditore të të moshuarve "Feti Rugji" Sarandë".
5. **P/vendim** "Për miratimin e draft marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Sarandë , Shqipëri dhe Bashkisë së Pardubicës, Çeki".
6. **P/vendim**"Për miratimin e nisjes së procedurës dhe miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit për pasuritë pronë private , që preken nga projekti "Poli i Zhvillimit Turistik Sarandë ".
7. **P/vendim**"Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.20 datë 16.05.2017 për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve".

8. **P/vendim** "Për miratimin e nivelit te pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të Bashkisë Sarandë dhe njësive në varësi".

9. Informacion mbi funksionimin e Qendrës së Zhvillimit dhe Qendrës Multifunksionale për zhvillimin e fëmijëve dhe fuqizimin e familjes në Bashkinë e Sarandës.

10. Raport mbi ecurinë e investimeve të vitit 2025.

11. Informacion mbi rishikimin e dokumentit të planit të përgjithshëm vendor.

Asaf Stroka: Hedhim në votim rendin e ditës .

Miratohet me 20 vota pro rendi i ditës .

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e parë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin janar 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Për këtë projektvendim u kërkua nga këshilltarët Përparim Ahmeti dhe Shpëtim Ahmeti mundësia e rritjes së masës së ndihmës ekonomike.
Nga ana e administratës u sqarua se masa e ndihmës ekonomike është e përcaktuar sipas Ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, të cilat përcaktojnë formulën dhe masën e përfitimit në bazë të përbërjes familjare dhe treguesve të tjerë ligjorë.
Kjo masë llogaritet automatikisht nga sistemi elektronik kombëtar dhe nuk përcaktohet apo ndryshohet nga administratori shoqëror apo nga njësia vendore.
Ligji nr. 57/2019 i atribuon Këshillit Bashkiak të drejtën për të miratuar kriteret për trajtimin me ndihmë ekonomike në nivel vendor, por jo për të përcaktuar apo ndryshuar masën e përfitimit financiar.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 19 vota pro, abstenim 0, kundër 1.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: **P/vendim**"Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin janar 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Për këtë projektvendim, u theksua se një rritje e masës së ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë do të krijonte pabarazi në trajtim dhe mund të sillte elementë diskriminimi mes përfituesve, duke cenuar parimin e barazisë në sistemin kombëtar të asistencës sociale.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 19 vota pro, abstenim 0, kundër 1.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: **P/vendim** "Mbi miratimin e projekt-propozimit për ofrimin e shërbimit"PAK përtej distancës".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi ndonjë pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 20 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e katërt të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e shtetases V.P për t'u trajtuar në qendrën polivalente ditore të të moshuarve "Feti Rugji" Sarandë".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 4 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 20 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e pestë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e draft marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Sarandë , Shqipëri dhe Bashkisë së Pardubicës, Çeki".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 5 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 20 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Largohet nga salla këshilltarja Farie Hyska.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e nisjes së procedurës dhe miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit për pasuritë pronë private , që preken nga projekti "Poli i Zhvillimit Turistik Sarandë ".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 6 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Shpëtim Ahmeti :Në projektvendimin nr. 13 kërkohet shpronësimi i disa pronave private, të cilat, sipas dokumentacionit, janë të pajisura me certifikata pronësie.

Më herët, kur ekzekutivi ka sjellë në Këshill projektvendime të ngjashme, ne kemi bërë disa herë denoncime,pasi kemi vlerësuar se prona publike e "Ekokampusit" po tjetërsohej për t'u kaluar në funksion të zhvillimit turistik, në mënyrë të ngjashme me rastin e polit të zhvillimit turistik. Për këtë arsye, konkretisht, nuk e kemi votuar atë projektvendim.
Kujtoj se prona publike, e ndërtuar në vitin 2017 me një investim rreth 700 milionë lekë, u realizua në partneritet ku 80% e financimit ishte nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Më pas, përmes një kontrate, përqindja e këtij fondi ndryshoi, pavarësisht vullnetit të palëve të interesuara.
Në një nga mbledhjet e para (ku personalisht nuk kam qenë i pranishëm, por kam marrë pjesë në mbledhjen e kryesisë), u shtua një projektvendim tjetër, me rreth 9200 m² sipërfaqe shtesë për zhvillimin e Ekokampusit.
Kam ngritur disa herë shqetësimin pranë drejtorit të urbanistikës nëse do të kishte probleme me shpronësimet dhe me pronat private që preken nga ky projekt. Sot po kërkohet shpronësimi i pronave private të individëve të veçantë, të cilët kanë tituj pronësie të rregullt. Këtu lind pyetja: a kemi të bëjmë realisht me një shpronësim për interes publik, apo me një zgjerim të mëtejshëm të sipërfaqes që më pas do të kalojë në funksion të zhvillimit turistik dhe, në praktikë, do të përfundojë si pronë private?
Çfarë ka ndryshuar në projekt që kërkohet shtesë sipërfaqeje?

Përparim Ahmeti : Nga informacioni që kemi, bëhet fjalë për parcela shumë të vogla 15m², 20m² për efekt rruge, por këtu shohim që ka parcela 200-300 m². Në disa raste, këto ndërhyrje prekin tërësisht pronën e qytetarëve: dikujt i preket godina, dikujt tjetër i merret e gjithë sipërfaqja funksionale.
Kërkoj një sqarim të qartë: a është kjo shtesë realisht për infrastrukturë rrugore në funksion publik, apo për zgjerim të sipërfaqes së polit të zhvillimit turistik?
Faleminderit.

Ibrahim Bajrami : kam disa shqetësime konkrete.
Së pari, nga sa shoh, aktualisht preken katër persona që janë të pajisur me certifikatë pronësie. Pyetja ime është: sa parcela të tjera preken nga ky proces, por ende nuk janë të pajisura me certifikatë pronësie?
Së dyti, konstatoj se të gjitha parcelat po vlerësohen me çmim reference, pa u marrë në konsideratë fakti nëse pronarët kanë kryer investime në to apo jo. Ka qytetarë që kanë investuar në këto prona ndër vite; disa prej tyre nuk e kanë ende certifikatën e pronësisë, por janë në proces prej më shumë se 15 vitesh dhe e konsiderojnë pronën si të tyren, pasi kanë paguar detyrimet përkatëse.
Nuk shoh që investimet e tyre të jenë marrë realisht në konsideratë në këtë vlerësim.
Nga ana tjetër, konstatoj se njërit prej qytetarëve i merren rreth 350 m². Për shumë familje, një parcelë e tillë përfaqëson një mundësi jetike për të ndërtuar një shtëpi, apo për të zhvilluar një ndërtim që do të siguronte të ardhura për ekonominë familjare. Disa prej këtyre pronave janë blerë dhe paguar që në vitin 1999, madje me pagesa të kryera ndaj Bashkisë Sarandë.
Ne kemi një detyrim moral dhe institucional ndaj këtyre qytetarëve, si ndaj atyre që janë pajisur me certifikatë pronësie, ashtu edhe ndaj atyre që, për arsye burokratike, ende nuk e kanë përfunduar procesin.
Për këtë arsye, kërkoj të rishikohet mënyra e vlerësimit dhe të shqyrtohet mundësia e një kompensimi me vlerë reale tregu, dhe jo thjesht me çmim reference, në mënyrë që qytetarët të mos dëmtohen padrejtësisht.

Faleminderit.

Zenel Bajrami: Për sa i përket pyetjeve të ngritura, dua të sqaroj disa çështje.

Së pari, asnjëherë në këtë Këshill Bashkiak, por as në diskutimet me administratën, nuk është deklaruar se nuk do të preket pronë private. Një pretendim i tillë është i pavërtetë dhe lehtësisht i verifikueshëm në procesverbalet dhe dokumentacionin përkatës.

Përkundrazi, në draft-marrëveshjen e paraqitur për miratim në muajin maj 2025, për zhvillimin e këtij projekti, është cituar qartë se do të kemi procese shpronësimi. Janë përfshirë edhe numrat e pasurive, bazuar në informacionin zyrtar të administruar përmes shkresave dhe përgjigjeve ngaASHK, sipas të dhënave që dispononim në atë moment.

Regjistrimi i pasurive është një proces që vijon pavarësisht ideimit apo miratimit të një projekti. Subjektet që disponojnë akte pronësie mund të regjistrojnë pasurinë në një moment të mëvonshëm, por kjo nuk i përjashton nga procesi i shpronësimit nëse prona e tyre përfshihet në projekt.

Arsyeja pse sot kemi një listë të rifreskuar me një ose dy numra pasurie më shumë, lidhet me përgjigjet e përditësuara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Edhe në draft-marrëveshje lista nuk ishte e mbyllur përfundimisht, pasi numrat e pasurive mund të ndryshojnë si pasojë e proceseve administrative në vijim. Ndryshimi i numrit të pasurisë nuk do të thotë ndryshim i pronësisë. Si shembull, edhe vetë Bashkia ka pasur katër numra pasurie për një aset të caktuar, të cilët më pas janë konsoliduar në një ose dy numra, pa ndryshuar pronësia.

Për sa i përket pretendimit se rruga prek sipërfaqe të plota prej 300–350 m², sqaroj se rruga nuk zë një parcelë të plotë në këto përmasa. Në rastin konkret të përmendur, bëhet fjalë për një pasuri që ndodhet brenda perimetrit të asaj që njihet si "vila qeveritare", e regjistruar që prej vitit 2002 si pronë private. Kjo pasuri nuk ka pasur servitut kalimi dhe, me zhvillimin e projektit, ajo rezulton e rrethuar nga një pronë tjetër private, çka e bën të pamundur garantimin e aksesit apo një zhvillimi funksional në mes të një hapësire të planifikuar si territor publik.

Këtu duhet të dallojmë dy koncepte: të drejtën e pronës dhe të drejtën e zhvillimit. E drejta e pronës mbetet e plotë për pronarin. Ndërsa e drejta e zhvillimit përcaktohet nga organet e planifikimit të territorit, një funksion i ndarë mes pushtetit vendor dhe atij qendror. Për këtë territor ekziston një rregullore e miratuar nga organet përkatëse kombëtare të planifikimit, e cila përcakton funksionin dhe përdorimin e zonës. Nuk është e mundur të lejohet zhvillim privat në mes të një hapësire të planifikuar si park apo lulishte publike.

Sa i përket vlerësimit financiar, që prej vitit 2020, pushteti vendor nuk ka kompetencë të përcaktojë vlerën përfundimtare të shpronësimit. Pas vendimit të Këshillit Bashkiak dhe angazhimit buxhetor për përballimin e kostos, procedura kalon në Agjencinë Shtetërore të Shpronësimeve, e cila cakton një vlerësues të licencuar për përcaktimin e vlerës finale.

Gjatë kësaj procedure, çdo qytetar ka të drejtë të dëgjohet, të paraqesë dokumente shtesë, të ankimojë dhe të mbrojë interesin e tij, pavarësisht nëse pasuria është e regjistruar apo në proces regjistrimi. Dokumentacioni shqyrtohet nga agjencia përkatëse sipas standardeve kombëtare.

Dritan Peçi: Nga pikëpamja juridike, doja të pyesja nëse një qytetar, prona e të cilit preket nga projekti, ka të drejtë të kërkojë rivlerësim të pasurisë.

Nëse sot ekziston mekanizmi i rivlerësimit, a mund të përdoret ai si një mundësi për të siguruar një kompensim më të drejtë si nga pikëpamja e çmimit të tokës, ashtu edhe për të ardhurat që ai mund të kishte gjeneruar nga ajo pjesë prone?

Pra, konkretisht: a ekziston opsioni ligjor i rivlerësimit dhe a ka të drejtë qytetari ta kërkojë atë?

Garufo Koka: Për të sqaruar procedurën, nga ana jonë janë ndjekur të gjithë hapat ligjorë, të përcaktuar në aktin përkatës .Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 128, i cili përcakton kriteret dhe mënyrën e vlerësimit të pasurive që shpronësohen.
Në relacionin bashkëlidhur projektvendimit janë pasqyruar të gjitha procedurat e ndjekura. Nga ana e bashkisë është tentuar të përdoren mekanizma sa më të favorshëm për pronat private që preken.
Për ndërtesat, ndonëse VKM parashikon mundësinë e vlerësimit mbi bazën e kostos së ndërtimit (që do të sillte një vlerë më të ulët), ne kemi kërkuar informacion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për çmimin mesatar të shitblerjes në zonë. Vlera e reflektuar në projektvendim bazohet pikërisht në këtë çmim mesatar të dokumentuar.
Për tokën, mekanizmat janë më të kufizuar, pasi ligji parashikon që vlerësimi të bëhet sipas çmimeve referencë të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
Gjithashtu, theksoj se vlera e paraqitur sot është një vlerësim paraprak "në parim". Vlera përfundimtare do të përcaktohet nga Agjencia Shtetërore e Shpronësimeve, e cila mund ta ndryshojë atë gjatë procedurës administrative.

Ilir Gërgjuqi: Kam një pyetje teknike. Në tabelën e paraqitur bëhet fjalë për shpronësimin e një ndërtese me sipërfaqe 425 m². Ndërkohë, në relacion referohet një sipërfaqe 97 m² për kat. Nëse objekti është shumëkatësh, atëherë 97 m² për kat shumëzuar me numrin e kateve rezulton rreth 457 m².
Kërkoj një sqarim për këtë mospërputhje numerike.

Zenel Bajrami :Në rastin e ndërtesave, informacioni merret nga certifikata e pronësisë dhe kartela përkatëse e pasurisë. Në certifikatë shënohet gjurma e ndërtesës, ndërsa në kartelë identifikohen sipërfaqet totale dhe planimetria.
Objekti në fjalë është regjistruar pas procesit të legalizimit. Aktualisht ekziston certifikatë pronësie për ndërtesën, por jo për truallin, pasi procedura për truallin ende nuk ka përfunduar.
Nga verifikimet rezulton se trualli i miratuar me leje legalizimi prek tre pasuri shtetërore të identifikuara me numra përkatës, të cilat do të përfshihen në vendimin përfundimtar të shpronësimit sipas procedurës.

Ibrahim Bajrami :Në krahun tjetër ndodhet një parcelë e madhe publike, ndërkohë që po prekim parcela të vogla private prej 60–90 m².
A nuk do të ishte e mundur të arrihej një marrëveshje alternative me këta qytetarë? Për shembull, një zgjidhje e dakordësuar ku të kishte një rishpërndarje apo kompensim tjetër, në mënyrë që dëmi për ta të mos ishte kaq i rëndë?
Disa prej tyre mund të jenë në proces aplikimi për leje ndërtimi, mund të kenë investuar në projekte që tani bëhen të pavlefshme. Këto kosto nuk mbulohen nga çmimet referencë.
Nëse ne miratojmë sot këto shuma, a u mbyllim atyre rrugën për të kërkuar një kompensim më të lartë në të ardhmen?

Zenel Bajrami :Sa i përket projektit, funksionet e përmendura janë të parashikuara si objekte publike dhe jo për zhvillim individual privat. Pasuria që u diskutua ndodhet brenda një zone të planifikuar si hapësirë e gjelbër (lulishte). Për më tepër, në kartelë ekziston një shënim për "regjistrim të parregullt", i cili do të verifikohet nga Agjencia e Shpronësimeve në kuadër të shqyrtimit administrativ.

Nga pikëpamja juridike, dua të theksoj se sot ne vetëm nisim procesin e shpronësimit. Vlera e paraqitur është një vlerësim paraprak për të kuptuar angazhimin financiar të bashkisë. Vendimmarrja përfundimtare mbi vlerën i takon Agjencisë Shtetërore të Shpronësimeve.
Sa i përket ndryshimeve të mundshme të projektit, legjislacioni i planifikimit të territorit parashikon që gjatë zbatimit të mund të bëhen rishikime teknike, nëse dalin vështirësi në terren.
Për projektet private kufitare me projektin publik, organi vendimmarrës është i njëjti që shqyrton edhe këtë projekt. Pra, çdo zhvillim do të vlerësohet në mënyrë të koordinuar nga i njëjti institucion kompetent.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin

Miratohen me 12 vota pro, abstenim 1, kundër 6.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.20 datë 16.05.2017 për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 7 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Ibrahim Bajrami: propozoj Neni 12 ndryshon si më poshtë:

Drejtuesi i taksisë, në rast të ndërprerjes së veprimtarisë të parashikuara në nenin 9 dhe në rast të pezullimit të përkohshëm të aktivitetit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, mbartë detyrimin për njoftimin e Bashkisë Sarandë, si dhe të kthejë lejen për ushtrimin e kësaj veprimtarie deri në momentin e rifillimit të aktivitetit.

Gjergji Imeraj : Pika 3 e nenit 8 të riformulohet si më poshtë:

Numri total i automjeteve taksi që mund të kenë operatorëve juridikë të shërbimit taksi ,nuk mund të kalojë 10% të numrit të përgjithshëm të taksive të personave fizikë.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin me propozimin e bërë nga z.Imeraj dhe z.Bajrami

Miratohet me 19 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Largohet nga salla këshilltari Shpëtim Ahmeti

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tetë të rendit të ditës **P/vendim** "Për miratimin e nivelit te pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të Bashkisë Sarandë dhe njësive në varësi".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 8 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 18 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës

Informacion mbi funksionimin e Qendrës së Zhvillimit dhe Qendrës Multifunksionale për zhvillimin e fëmijëve dhe fuqizimin e familjes në Bashkinë e Sarandës.

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 9 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës

Raport mbi ecurinë e investimeve të vitit 2025.

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës

Informacion mbi rishikimin e dokumentit të planit të përgjithshëm vendor.

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka : Duke ju falenderuar, e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Ky proçesverbal mbyllet me nr.rendor 9 (nëntë) fletë, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe komisioni i verifikimit të procesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Valbona Vasili

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

1.	Kryetar i Këshillit Bashkiak :	Asaf Stroka
2.	Partia Socialiste e Shqipërisë:	Lindita Kondi
3.	Partia,Drejtësi,Integrim dhe Unitet:	Klejdjan Murtaj
4.	Partia Balli Kombëtar:	Bejdo Çela
5.	Partia Republikane Shqiptare :	Përparim Ahmeti
6.	Fryma e Re Demokratike:	Ilir Gërdhuqi
7.	Kryetar i Grupit Bashkë Fitojmë:	Shpëtim Ahmeti
8.	Kryetar i Grupit Partia Demokratike:	Vesel Koçiu
9.	Aleanca Arbnore Kombëtare:	Xhino Jaçaj
10.	I pavarur	Kevin Alikaj